

**V E N D I M**  
**Nr.450 datë 16.9.1993**

**PËR RIVLERËSIMIN DHE RISHPËRNDARJEN NË VLERË TË PASURISË SË ISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE**

Në zbatim të ligjit nr.7745, datë 26.7.1993 "Për rivlerësimin dhe rishpërndarjen në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Duke u mbështetur në dokumentacionin për vlerësimin e asurisë së ish-kooperativave bujqësore dhe të provave të tjera të bëra nga komisionet e ngritura për këtë qëllim sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.266, datë 8.8.1991 "Për ndarjen e asurisë në kooperativat bujqësore", si dhe të komisioneve për ivlerësimin dhe rishpërndarjen e pasurisë së ish-koopertivave bujqësore, në çdo ish-kooperativë bujqësore të bëhet rivlerësimi kësaj pasurie si vijon :

a) Kur pasuria e vlerësuar është bërë sipas kriterëve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.266, datë 8.8.1991, dhe ende nuk është shpërndarë, shpërndarja të bëhet me çmimet e asaj periudhe, por duke bërë indeksimin e lekut në çastin e ivlerësimit.

b) Kur pasuria e vlerësuar është bërë sipas kriterëve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.266, datë 8.8.1991, dhe u shtë shpërndarë personave, por nuk është arkëtuar vlefata, të bëhet rivlerësimi i pasurisë me çmimet e asaj periudhe, duke bërë ndeksimin e lekut në çastin e rivlerësimit.

c) Kur pasuria është vlerësuar e shpërndarë dhe janë kryer rkrëtimet nga shitja para datës 30 nëntor 1991, quhet e mirëqenë, pra nuk bëhet indeksimi i lekut.

2. Për zbatimin e ligjit nr.7745, datë 26.7.1993, formohet komisioni qeveritar me këtë përbërje:

|                    |                                                              |
|--------------------|--------------------------------------------------------------|
| - Fahri Dahri      | drejtor i financës në Ministrinë e Bujqësisë dhe të ushqimit |
| - Niko Gjokoreci   | drejtor i Bankës së Bujqësisë dhe të Zhvillimit              |
| - Rasim Borici     | drejtor i Policisë në Ministrinë e Rendit Publik             |
| - Nezir Aldeta     | specialist në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë        |
| - Aleksandër Nushi | drejtor në Bankën e Bujqësisë dhe të Zhvillimit              |
| - Naim Çelmeta     | specialist në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit         |
| - Fatos Gjini      | specialist në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit         |

Këshillat e rretheve të formojnë komisionet në shkallë rrethi, në përbërje të të cilave të jenë specialistë nga drejtoria e bujqësisë dhe e ushqimit, seksioni i kontrollit të rrethit, dega e bankës së bujqësisë dhe të zhvillimit, seksionet e financës dhe të degës së rendit publik.

Çdo komunë ose bashki krijon komisionet për vlerësimin, rivlerësimin dhe rishpërndarjen e pasurisë së ish-kooperativave bujqësore.

Komisionet e komunës ose bashkisë i paraqesin llogaritjet për rivlerësimin dhe rishpërndarjen e bërë në këshillin e komunës ose bashkisë, të cilët i miratojnë brenda datës 31.12.1993.

Vendimet e Këshillit të Komunës ose bashkisë për rivlerësimin dhe rishpërndarjen e pasurisë së ish-kooperativave bujqësore janë tituj ekzekutive.

3. Në punën e tyre komisionet e komunës ose bashkive mbledhin çdo deklaram për pasurinë e ish-kooperativave bujqësore, të marrë në mënyrë të paligjshme e të padokumentuar.

Nëse personi që ka kryer përvetësim e mohon atë dhe nuk shlyen detyrimin që rrjedh nga kjo, çështja dërgohet për ndjekje penale nga komisioni i komunës ose bashkisë.

Rivlerësimi sipas kriterëve të nenit 1 të ligjit nr.7745, datë 26.7.1993, i nënshtrohen edhe

detyrimet që kanë personat fizikë a juridikë, të cilët janë debitorë ndaj ish-kooperativave bujqësore, pra duke bërë indeksimin e lekut.

4. Në pasurinë e ish-kooperativave bujqësore do të vlerësohen të gjitha mjetet themelore të tyre, pavarësisht nga burimet e financimit, si ato të krijuara me mjetet e tyre financiare, me kredi bankare e me pjesëmarrje shtetërore. Nga kjo bën përjashtim vetëm vlefte e tokës që paguajnë blerësit, pasi këto të ardhura derdhen në buxhetin e shtetit.

5. Në përfundim vlera totale e llogaritur sipas këtij rivlerësimi do të shpërndahet sipas kontributit të çdo personi qënga krijimi i pasurisë së ish-kooperativës bujqësore. Kontributi i secilit matet me shpërblimin e marrë prej tij për punën e kryer në kooperativave nga çasti i krijimit deri në shpërndarjen përfundimtare të saj.

6. Të gjithë personat që kanë pretendime për rivlerësimin e rishpërndarjen e vlerës së pasurisë së ish-kooperativave bujqësore, t'ia paraqesin ato konkretisht e me argumente me shkrim komisionit të komunës ose bashkisë brenda muajit nëntor të vitit 1993. Këtë të drejtë e kanë edhe trashëgimtarët. Pas këtij afati nuk merret në konsideratë asnjë pretendim.

Për kooperativat bujqësore që janë ndarë pas datës 1 janar 1991, rishpërndarja bëhet mbi bazën e ish-kooperativës së bashkuar.

7. Komisionet e komunës ose bashkisë, kur e çmojnë të nevojshme për të marrë shpjegime nga gjithë personat që kanë qenë me përgjegjësi materiale e administrative në ish-kooperativat bujqësore, u jepet e drejta për t'i thirrur dhe ata janë të detyruar të paraqiten para komisionit.

8. Komisionet e ngritura në zbatim të ligjit nr.7745, datë 26.7.1993, detyrohen të bëjnë denoncim në organet e drejtësisë për rastet kur vërejnë abuzime, falsifikime etj. gjatë procesit të vlerësimit dhe shpërndarjes së pasurisë.

9. Mbi bazën e vendimeve të vlerësimit e të shpërndarjes së pasurisë, zyrat e financës në këshillin e komunës ose bashkisë vjelin detyrimet e personave fizike e juridike që kanë për të kthyer, edhe ua shpërndajnë ato personave që kanë për të marrë.

Kështu veprohet edhe për detyrimet e tjera që kanë klientë të ndryshëm dhe që nuk kanë shlyer detyrimin ndaj ish-kooperativave bujqësore. Edhe veprimet me bankë për efekt të zbatimit të këtij vendimi kryhen nga këto zyra.

Vjelja dhe rishpërndarja e pasurisë realizohet brenda vitit 1994. Për realizimin e vjeljes së detyrimeve zyrat e financës në komunë ose bashki zbatojnë kriteret e përcaktuara në dekretin "Për nxjerrjen e të ardhurave shtetërore dhe detyrimeve të tjera".

10. Këshillat e komunave ose të bashkive, përveç specialistëve të tyre (financierë, agronomë, zooteknikë, veterinerë) dhe specialistë të asistencës teknike të drejtorive të bujqësisë e të ushqimit në rrethet që do të caktohen nga komuna, pjesëtre të komisioneve të rivlerësimit e rishpërndarjes së pasurisë së ish-kooperativave bujqësore kanë të drejtë të caktojnë edhe një ekonomist që të jetë kryetar i këtij komisioni, i cili paguhet sipas klasës XVII, pagë që përballohet nga rishpërndarja e të ardhurave të ish-kooperativave bujqësore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**